

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.7 (373)

KORRIK 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

HISTORIA



**NGJARJE
KULMORE
NË
HISTORINË
E LANÇ**

Rrahman PARLLAKU

FAQE 2

PROFILI



**KONTRIBUTI
I FAMILJES
ÇOLLAKU
GJATË
LANÇ-it**

Ing. Myfit Guxholli

FAQE 6-7

KONFERENCA 21 E KASH

**SFIDAT E SOTME DHE ÇËSHT-
JET RAJONALE TË SIGURISË**



Nga Halil Rama

FAQE 5

***JUBILARE** - Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar
është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të Veteranëve*

25 vjet OBVL – HISTORI SUKSESI

PAJTIMI KOMBËTAR, DOMOSDOSHMERI HISTORIKE

Halil RAMA

Gjeneral Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit në moshën e thyer mbi shekullore, përballë revanshit të nostalgjikëve të diktaturës komuniste dhe ekstremistëve pa fre të të dyja palëve, përsërit kërkesën për klasën politike shqiptare që t'i rikthehen arsyes së shëndoshë, për të realizuar PAJTIMIN KOMBËTAR, aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e të gjitha kohërave.

Në emër të Kryesisë së Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, kryetari i OBVL Parllaku shpreh shqetësimin për kaosin institucional ku është futur vendi dhe për klimën konfliktuale që krijuan palët në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Kryeneqësia e lidershit qeveritar dhe mosdakortësia e atij opozitar po e çojnë vendin drejt një konflikti civil me pasoja të paparashikuara. Ndaj dhe OBVL bën thirrje për dialog, nga i cili të arrihet në një kompromis historik në funksion të mbajtjes së zgjedhjeve të lira e demokratike dhe konsolidimit të shtetit ligjor.

Në këtë situatë, kryesia e OBVL e gjykon të drejtë qëndrimin e Presidentit të Republikës, i cili me aktet e tij ligjore, publike bëri të gjitha bërpkjet për të ndikuar për Pajtimin Kombëtar, në një kohë kur grindjet, shpifjet, sharjet, sherret e sherrnajat po kthehen në institucion.

VËJON NE FAQEN 4



• *Libri që u botua para pesë vitesh në 20 vjetorin e OBVL pasqyron gjërësisht, ndonjëherë edhe në detaje, pa pretenduar se ka thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve që milituan dhe militojnë aktualisht (si anëtarë dhe pasardhës), në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave, duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë legjendare që e renditi Shqipërinë në kra-hun e fitimtarëve të Luftës së II-të Botërore*

FAQE 3

PROFILI

Doktore e shkencave, gjenerale dhe juriste me karrierë të shkëlqyer



**Dr.Manushaqe
Shehu, e vetmja
grua shqiptare
Gjeneral Brigade në
drejtimin e FA**

FAQE 5

REFLEKSIONE

**NGA PLANET GJENOCIDE
SERBE DERI TE ÇLIRIMI I
KOSOVËS**

Bashkim Hisari

FAQE 8

HISTORIA

**PARTIZANËT DIBRANË
ME 8 SHTATOR 1943
VENDOSËN FLAMURIN
SHQIPTAR NË DIBËR
TË MADHE**

Nga Sakip CAMI

FAQE 9

LIBRI

**KUR LETËRSIA I
VJEN NË NDIHMË
HISTORISË**

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 10

PROMOVIMI

**Enciklopedia e plotë për
Dibrën, punim me vlera
shkencore nga Fatos Daci**



FAQE 11

Prof.dr.Bernard Zotaj

HISTORIA

76 - VJETORI – Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, datë që nuk duhet harruar

NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ

Rrahman PARLLAKU*

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 76 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Në këtë shkrim nuk kam marrë përsipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare, atë të krijimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjykoj se kjo datë do të zerë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë.

Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësitë guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin, jo të veçuara nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut. Po në korrik të atij viti filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastrës, Korçës e Beratit. Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës të përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste. Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësive që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe territoriale, ashtu edhe për krijimin e njësive taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin. Rritja sasiore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 76 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit

• *Një vit më vonë në Kongresin e Përmetit, Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqëndroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të kryeministrit, të ministrit të jashtëm etj. Por siç dihet ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgaditura, si dhe komandat e njësive e të reparteve*



• *Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 76 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës*

të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i paisur me kulturë ushtarake.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës të kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëherëshme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e teritorit të vendit dhe forcat territoriale që vareshin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliuara qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj. Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitë e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësive e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Kjo iniciativë ishte më se e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt, mjete teknike të ndërlidhjes e të drejtimit, mungonin kryesisht, komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

PARTIZANËT PËRBALLUAN VËSHTIRËSI MBINJERËZORE

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë kushtet tepër të vështira në të cilat vepronte dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgaditi e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinën ushtarake, të kombinimit të disiplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj. Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhënjet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgaditja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitë e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballonjë vështirësi, do të thoshja mbinjerëzore.

Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitë e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm që e befaso i keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

NDRYSHIMET ORGANIZATIVE ISHIN TË KARAKTERIT OPERATIVO-STRATEGJIK

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësive të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në hapësira të mëdha të teritorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore. Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësive që ishin të karakterit operativo-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin An-

tifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitë operative strategjike. Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqëndroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të kryeministrit, të ministrit të jashtëm etj. Por siç dihet ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgaditura, si dhe komandat e njësive e të reparteve.

Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit '44 duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi që kish marrë lufta, shtimi e forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇL për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të patur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në këshilla e kishin shqiptarët.

Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kundër Aleatëve. Në këtë aspekt është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish Jugosllavi për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që



vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

*Kryetar i OBVL, gjeneral-lejtënant (në pension), Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit (Nga libri "NJË SHEKULL NË MEMORIE")

JUBILARE

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të Veteranëve

25 vjet OBVL – HISTORI SUKSESI

Më 18 korrik mbushen 25 vjet nga krijimi i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar.

OBVL është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit diktatorial të E.Hoxhës, mohimet dhe politizimet e bëra nga historiografë të atij regjimi, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamërituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë për karriket e tyre.

Për të penguar këtë qasje negative, këtë tendencë të dëmshme si për demokracinë ashtu edhe për historinë e popullit shqiptar me nismën e një grupi pre 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, para 25 vitesh u formua Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL).

Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e ministra, siç ishin: Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçami, Maqo Çomo, Sadik Bekteshi (gjeneral lejtnant-Hero i Popullit), Muhamet Prodani (gjeneral lejtnant-Hero i Popullit), gjeneral-majorët: Nexhip Vinçani dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Poiani), Mine Doraci e disa të tjera, por Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve 25 vjet OBVL fatkeqësisht dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Kuvendi i parë themelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) në krye të saj zgjodhi personalitetin e shquar Dr. Ymer Dishnicën.

OBVL i bëri thirrje Komitetit Kombëtar të Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare për bashkim, por me kushitin e zgjedhjeve të reja në bazë dhe në qendër të veteranëve, të ndryshimit të statutit dhe programit, të rishikimit të historisë së LANÇ, të dënimit të krimeve të komunizmit. Këto kërkesa u refuzuan nga Komiteti Kombëtar i Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare.

Menjëherë pas zgjedhjes, Kryesia e OBVL ju vu punës për përgatitjen e

Libri që u botua para pesë vitesh në 20 vjetorin e OBVL pasqyron gjërësisht, ndonjëherë edhe në detaje, pa pretenduar se ka thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve që milituan dhe militojnë aktualisht (si anëtarë dhe pasardhës), në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave, duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë legjendare që e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II-të Botërore



GRUPI NISMËTAR PËR FORMIMIN E OBVL-së

1.Andon	Sheti
2.Ali	Bulka
3.Alfred	Moisiu
4.Bedri	Shehu
5.Dashamir	Othi
6.Delo	Balili
7.Edip	Othi
8.Ernest	Jakova
9.Elami	Hadjo
10.Guri	Shyti
11.Haki	Jupasi
12.Hamid	Keçi
13.Hysni	Daja
14.Irakli	Bozo
15.Islam	Beshi
16.Janaq	Budina
17.Josif	Zegalli
18.Kiço	Ngjela
19.Koço	Qiliczi
20.Muhamet	Prodani
21.Masar	Shehu
22.Mermer	Belega
23.Mylit	Çardholli
24.Manol	Konomi
25.Myltar	Tare
26.Norie	Bozo
27.Nexhip	Vinçani
28.Ndreci	Pisani
29.Neshat	Iljazi
30.Fetef	Myltari
31.Fetrit	Malindi
32.Rahman	Parllaku
33.Skënder	Godo
34.Sami	Hadëri
35.Sami	Vinçani
36.Sotir	Budina
37.Sitki	Bushati
38.Koço	Lezhja
39.Kolë	Jakova
40.Lavdes	Dilaj
41.Mushin	Kroi
42.Myozer	Mali
43.Mato	Hasanataj
44.Mehamer	Spahiu
45.Shefqet	Mezini
46.Shiraf	Gjebra
47.Tago	Adhami
48.Tahir	Voshitina
49.Tamush	Shyti
50.Vangjel	Babi
51.Selimo	Broja
52.Sazan	Xhebo
53.Skënder	Malindi
54.Seit	Berisha
55.Shkëlqim	Zaloshnja
56.Shaban	Reçi
57.Shemsi	Sadiku
58.Vangjel	Pritanji
59.Vera	Pojani
60.Xhavit	Qesja
61.Ymer	Dishnica
62.Zenepe	Ashiku
63.Zekë	Voshitina
64.Neshimi	Balka

projektligjeve e që do të vinin në vendin e merituar figurën e respektuar të veteranit të LANÇ dhe propozimin e miratimit të tyre në parlament, duke e vënë kështu veprimtarinë e saj mbi baza ligjore në interes të veteranëve, invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Në këtë mënyrë u ligjërua figura e respektuar e veteranit të LANÇ.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ u shtri rrefeshëm në gjithë Shqipërinë. U krijuan dhe u konsoliduan degët tona në rrethet si vijon: Në Tiranë me kryetar z.Muhamar Spahiu, Korçë, me kryetar z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz Hoxha, Shkodër me kryetar z.Murrem Bushati, Lushnjë me kryetar z.Iliaz Ahmeti, Krujë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Nezir; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit. Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Trifon Llupo (Tiranë), Muharem Kamani (Permet), Xhemal Meçi (Pukë), Ali Demushi(Shkodër) etj.

Pas viteve 90 dhe ndryshimeve demokratike që ndodhën në Shqipëri, një kontribut dha edhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL). Është i njohur

kontributi i saj gjatë procesit të ndryshimeve demokratike e deri më sot.

Libri që u botua para pesë vitesh në 20 vjetorin e OBVL pasqyron gjërësisht, ndonjëherë edhe në detaje, pa pretenduar se ka thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve që milituan dhe militojnë aktualisht (si anëtarë dhe pasardhës), në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave, duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë legjendare që e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II-të Botërore.

Që nga krijimi i saj në korrik 1994, OBVL ka mbajtur gjashtë kuvende kombëtare, ku më i fundit, ai i datës 28 Maj 2017 shënoi një rekord anëtarësimesh të reja nga pasardhësit.

Gazeta Veterani, organ i OBVL pasqyroj dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj.

Përveç përvjetorëve të shokëve të rënë në luftë, të pushkatuarit nga diktatura, të vdekurit në burgje e internime, si dhe të figurave patriotike me kontribute të veçanta në luftat për liri kombëtare, përkujtimeve të shokëve që kanë vdekur gjatë kësaj periudhe, veprimtarive të tjera në bashkëpunim me pushtetin vendor në përjetësim të LANÇ, OBVL u bë promotor në mbrojtje të luftës së UÇK dhe të luftës së Kosovës, të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, Preshevë, Maqedoni, Mal të Zi, të komunitetit çam etj.

Në përkujtim të këtyre ngjarjeve e figurave, OBVL në qendër e rrethe ka bashkëpunuar me organet e pushtetit, organizatat e shoqatave që zhvillojnë veprimtari shoqërore e patriotike.

OBVL ishte nismëtare në bashkimin e 64 organizatave e shoqatave joqeveritare që u angazhuan totalisht në mbështetje e ndihmë të luftës çlirimtare (UÇK) në Kosovë. Organizata jonë e ka mbështetur edhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni e Luginën e Preshevës për të fituar liritë nacionale e të drejtat njëzëre. Ne kemi mbështetur e mbështesim komunitetin çam në përpjekjet për të fituar të drejtat e mohuara.

Që në ditët e para të çlirimit të

Kosovës kemi vendosur lidhje e bashkëpunim të ngushtë me Organizatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës; bashkë kemi përkujtuar shumë ngjarje të luftimeve për liri e pavarësi e në veçanti ato të LANÇ. Kemi krijuar dhe kemi lidhje të ngushta mes dy kryesive të shoqatave tona. Kryetari i OBVL-së, gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, ruan në kujtesën e tij figurat e paharruara drejtues të kësaj organizate si: Ramadan Vraniqi, Xhevdet Pula, Vahide Hoxha, Vehap Shita, Pajazit Nushi, etj, me të cilët ka patur bashkëpunim të frytshëm. Ndërsa tani ai ndjehet i nderuar që bashkëpunon me të respektuarit Zija Mulhaxha, Skënder e Lek Hoxha, Drita Rexhepi, Bashkim Hisari e anëtarë të tjerë të Kryesisë të kësaj organizate, bashkëpunim që ka rezultuar në veprimtari të përbashkëta si në Shqipëri dhe në Kosovë. Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen dhe aktivitetet e këtyre federatave, jo vetëm në Europë, por edhe në Maljazi, në Johannesburg, Marok etj kemi bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II-të Botërore dhe të luftimeve për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që japim sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s.



FESTA

20 vjetori i Çlirimit



Vizitë historike e Clinton dhe Albright në Kosovë



Në ditën e madhe për popullin e Kosovës, në 20-vjetorin e çlirimit e ndërhyrjes së NATO-s, në Prishtinë ishin të pranishëm ish-presidenti Bill Clinton dhe ish-sekretarja amerikane Madeleine Albright.

Në agjendën e 20 vjetorit të lirisë ishte edhe aktiviteti “Ecja për Liri”. Kryeministri Ramush Haradinaj, në kuadër të aktivitetit “Ecja për Liri”, mori pjesë edhe në përurimin e bustit të Sekretares së Shtetit, Madeleine Albright. Gjithashtu, kryeministri Haradinaj, mori pjesë edhe në zbulimin e

plakës me emrin “Bulevardi Bill Klinton”, e cila u bë afër shtatores së presidentit Klinton në Prishtinë.

Kryeministri Haradinaj ka

falënderuar qytetarët që sot festuan me dinjitet dhe qytetari të lartë, shënimin e 20 vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. “Popul-

li i Kosovës, qytetarët tanë, institucionet tona, të ndërtuara në shtetin e lirë të Kosovës, sot iu bashkuan me dinjitet dhe festuan me qytetari të lartë, shënimin e 20 vjetorit të NATO-s, ashtu siç e meriton, një vend i lirë, demokratik dhe i rreshtuar përkrah aleatëve tanë. Faleminderit qytetarë të dashur. Faleminderit Kosovë!”, ka thënë kryeministri Haradinaj. (Express)



Pullat postare “20 Vjetori i Lirisë”



i ka populli ynë, Presidentin e SHBA-ve, Bill Clinton, dy Sekretareve të Shtetit, zonjës Madeleine Albright dhe Hillary Clinton, Kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar, Tony Blair, si dhe Komandantit Suprem të NATO-s, gjeneralit Wesley Clark në 20 vjetorin e Çlirimit të Kosovës.

Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sedji Hoxha, së bashku me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, me nderime të larta e pritën dhe i dhuruan pullën e parë postare të punuar në bronz me imazhin e mikut tanë më të çmuar amerikan, që sot ariti në Kosovë, Presidenti i SHBA-ve, Bill Clinton.

Këto personalitete botërore janë meritore që përkrahen luftën e drejtë të UÇK-së, organizuan Konferencën e Rambujesë për Kosovën, morën vendimin për fillimin e bombardimeve të NATO-sndaj ushtrisë pushtuese ish jugosllave, shpëtuan popullin shqiptar të Kosovës nga spastrimi etnik dhe gjenocidi serb.

Populli i Kosovës do t'u mbetet përjetësisht mirënjohës këtyre personaliteteve dhe shteteve anëtare të NATO-s që ishin të rreshtuara në krah me të drejtën tonë historike, ato hynë triumfalisht në Kosovë, më 12 qershor 1999, si dhe jemi shumë falënderues për qëndrimin e tyre 20-vjeçar në ruajtjen e paqes.

Filatelia e Postës së Kosovës është përkujdesur që përmes pullave postare të nderojë miqtë e popullit të Kosovës në 20 vjetorin e lirisë, ashtu siç e nderuam ditë më parë edhe ish Presidentin e SHBA-ve, Woodrow Wilson për përkrahjen që i dha kombit shqiptar para 100 vitesh në Konferencën e Paqes në Paris.

Ju faleminderit përjetësisht miqve të Kosovës!

Zoti ju bekoftë Ju dhe familjet e juaja!

Urime gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës 20 Vjetori i Lirisë!

Lavdi e përjetshme gjithë dëshmorëve dhe të rënëve për Liri!

Prishtinë, 11 qershor 2019 - Në kuadër të tematikës “20 Vjetori i Lirisë”, Posta e Kosovës promovon pesë pulla postare me imazhet e miqve më të mëdhenj që

Kosova nderon Bill Klintonin për ndërhyrjen e NATO-s në luftën e 1999



Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara Bill Klinton mori Urdhrin e Lirisë të Kosovës nga presidenti Hashim Thaçi pasi mbërriti në Prishtinë për të përkujtuar 20-vjetorin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.

Ish-presidenti amerikan Bill Klinton dhe presidenti i Kosovës Hashim Thaçi. Foto: BIRN.

Kosova nderoi Bill Klintonin për rolin e tij në urdhërimin e bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavinë, që çoi në përfundimin e luftës 20 vjet më parë.

“Ju falënderojmë për vendimin e drejtë për të ndaluar gjenocidin serb gjatë vitit 1999. Ne jemi shumë mirënjohës për mbështetjen e SHBA-së për Kosovën. Historia e Kosovës është një histori suksesi të përbashkët. Ju jeni heroi ynë,” i tha presidenti Hashim Thaçi Klintonit.

“Unë do të jem gjithmonë krenar për faktin se isha presidenti i Shteteve të Bashkuara kur ju kishit nevojë që dikush të ngrihej dhe të thoshte mjaft më me spastrim etnik, mjaft më me njerëz që largohen nga shtëpitë e tyre, mjaft më me vrasje civilësh të pafajshëm, duhet të ketë një mënyrë tjetër,” u përgjigj Klinton.

Ish-presidenti amerikan mbërriti në Kosovë përpara përkujtimeve që do të mbahen të mërkurën me rastin e 20 vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në vend.

Ish-Sekretarja Amerikane e Shtetit Madlen Ollbrajt është gjithashtu në Kosovë, ku një statujë e saj do të inaugurohet në Prishtinë të mërkurën.

NATO nisi fushatën 78-ditore të sulmeve ajrore kundër Serbisë në vitin 1999 në një përpjekje për të detyruar presidentin e atëhershëm Slobodan Millosheviç të pranonte kushtet e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund fushatës së tij ushtarake kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila përfshinte spastrime dhe vrasje të gjera etnike të civilë shqiptarë të Kosovës.

Pas tërheqjes së trupave të Millosheviçit në qershor të vitit 1999, forcat e NATO-s hynë në vend. Forca e NATO-s në Kosovë, KFOR, është vendosur në vend që nga ajo kohë.

PAJTIMI KOMBËTAR, DOMOSDOSHMERI HISTORIKE

(Vijon nga faqja 4)

OBVL mbështet edhe platformën me pesë pika të propozuar nga ish-Presidenti Moisiu e cila referon anulimin e ndryshimeve kushtetuese 2008, rishikim të Kushtetutës, hetim për trafikun e votës etj. Kjo mund të arrihet vetëm me dialog politik që palët të vendosin interesat e vendit mbi ato të partive. “Krizë po përkeqësohet. Është koha për një zgjidhje në interes të Shqipërisë dhe jo në kurriz të saj. Koha për një zgjidhje afatgjatë për të mos u përsëritur krizat ciklike. Janë të pa tolerueshme nxitja e urrejtjes mes shqiptarëve për interesa partiake; përdorimi i shprehjeve luftënxitëse e përçarëse; retorika denigruese ndaj rivalëve dhe ndaj secilës palë politike; mungesa e dialogut”-ka deklaruar Moisiu. Kjo për faktin se këta faktorë kanë çuar në cenim të sigurisë së qytetarëve, dëmtojnë demokracinë e brishtë shqiptare, po cenojnë imazhin e Shqipërisë në botë.

PROFIL

Doktore e shkencave, gjenerale dhe juriste me karrierë të shkëlqyer

Dr. Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare Gjeneral Brigade në drejtimin e FA

Halil RAMA

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, është e vetmja grua shqiptare që mban këtë gradë. Numri dy i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (Nga data 16 janar 2018 e në vijim kryen detyrën e Zëvendëshefit të SHP të FA) vjen në këtë funksion mjaftë të rëndësishëm pas një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptare.

Veçanërisht, dibranët krenohet me profilin e vajzës së tyre, doktore e shkencave, gjenerale dhe juriste. Mbi të gjitha tek ajo spikasin vlerat njerëzore. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare.

Si njohëse në mënyrë perfekte e dy gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht), dr. Manushaqe Shehu, ka përfunduar kursin e CIMIC në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (mars - prill 2013), Kursin Gender



Perspective in Peacekeeping Operations në Zagreb, Kroaci, (qershor

2014), studimet për CIMIC&CIMI Oberamengau, Gjermani (shtator

• *Është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, si dhe medalje të tjera e Çertifikata si “Sportiste e dalluar”, “Në ndihmë të popullsisë në donacione të ndryshme”, “Aktiviste e zbatimit të rezolutës 1325”.*

- tetor 2015), Kursin “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore” në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (maj 2016), Kursin e Leadershipit Strategjik, Budva, Mal i Zi (shtator 2016), Kursin e Sigurisë në “Qendra Marshall”, Garmish, Gjermani (korrik - shtator 2017) si dhe kursin “Building Integrity” në Mbretërinë e Bashkuar (Tetor 2017). Në muajin gusht 2018 në mbrojtje të temës “Leadershipi dhe ndikimi i tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë. Rasti i Ballkanit e më gjerë”, fiton gradën shkencore “Doktor”. Ajo ka botuar një sërë artikujsh shkencorë dhe joshkenor brenda e jashtë vendit, në Revista Ushtarake, në shtypin ushtarak e civil. Po ashtu ka marrë pjesë në disa aktivitete ushtarake ndërkombëtare në vendet anëtare

të NATO-s dhe ato partnere të saj.

Dhe jo vetëm kaq, si intelektuale bashkëkohore demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të saj ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ajo besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. E qetë, e pjekur, shumë e kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e vërtetshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinjoretetit dhe dinjitetit. Kuptohet ajo ishte dhe është

(Vijon në faqen 12)

Sfidat e sotme dhe çështjet rajonale të sigurisë

Halil RAMA

Zhvillimet e fundit në rajonin Ballkanik nxjerrin në pah domosdoshmërinë e mbizotërimit të një klime më të fortë besimi dhe respekti reciprok. Po ashtu kërkohet të forcohet më shumë bashkëpunimi midis të rinjve të Ballkanit për të respektuar vlerat, traditat dhe kulturën e vendeve fqinje. Në këtë kuadër, Konferenca e 21-të Ndërkombëtare e Këshillit Atlantik të Shqipërisë, që u mbajt në Tiranë, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Zyrës së Diplomacisë Publike të NATO-s me temë: “Reflektime për një të ardhme paqësore dhe të sigurtë të Ballkanit Perëndimor” theksoi rolin e madh që duhet të luajnë Shoqëria civile në tërësi dhe Këshillat Atlantike në veçanti.

Në këtë konferencë ku morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, nga Organizata e Rinisë Atlantike në Bruksel, etj, dr. Arian Starova, President i Këshillit Atlantik, u përqëndrua në disa aspekte të gjendjes së sotme të sigurisë në Ballkanin Perëndimor si dhe në rolin që po luan në këtë situatë shoqëria civile dhe Këshilli Atlantik.



Konferenca u përqëndrua në shprehjen e ideve dhe zgjidhjeve mbi sfidat e sotme dhe çështjet rajonale të sigurisë, përshtetimin e procesit të integrimit, shfrytëzimin e të gjitha mundësive të vendeve tona dhe të këshillave të tyre atlantike për forcimin e sigurisë dhe arritjeve të deritanishme në Ballkanin Perëndimor, etj.

Në fjalet e mbajtura, komentet dhe diskutimet që vijuan, veç vlerësimit mbi arritjet që vendet e rajonit kanë bërë në forcimin e institucioneve demokratike, në forcimin e paqes dhe sigurisë u nënvizuan edhe fenomenet negative që çenojnë klimën e besimit dhe bashkëpunimit.

Zëvendës Ministri i Mbrojtjes Petro Koçi, ndërsa vlerësoi kontributin e Këshillit Atlantik të Shqipërisë në ecurinë e proceseve të integritetit euroatlantike, e vuri theksin në domosdoshmërinë e forcimit të

kapaciteteve qeverisëse dhe konsolidimin e shtetit ligjor në vendin tonë dhe në vendet e rajonit. Natyrisht që një nga çështjet e nxehta që u diskutuan ishte dialogu Kosovë - Serbi dhe gjetja e rrugëve më efikase për rifillimin e tij dhe gjetjes së një zgjidhjeje finale. U hodhën idë dhe u theksua nevoja për një luftë e përpjekje më të mëdha ndaj fenomenit të nacionalizmit agresiv që shpesh vihet re në vendet tona, për të intensifikuar më tej luftën kundër korrupsionit që ku më shumë ku më pak, ka prekur të gjitha vendet e rajonit. Me interes ishin mendimet e dhëna në drejtim të projekteve madhore ekonomike në rajon si element shumë i rëndësishëm për bashkëpunimin, mirëqënien e siguri rajonale, si dhe për rolin më të madh dhe të veçantë, që vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të luajnë për Dialogun Mesdhetar në kuadër

të Iniciativës së Stambollit për Bashkëpunim. Konferenca u ndal edhe në rolin që Aleanca Atlantike ka luajtur gjatë gjithë historisë së saj 70 vjeçare për sigurinë dhe paqen në botë, por veçanërisht për paqen në rajonin tonë.

Folësit nënvizuan rëndësinë që merr sot parandalimi i sulmeve terroriste. Në këtë kuadër u kërkua një bashkërendim më i mirë i shërbimeve të inteligjencës së Aleancës, për të evidencuar të gjithë elementet e dyshuar dhe për t'i mbajtur ata nën kontroll të pandërprerë në të gjithë territorin ku shtrihet NATO. Konferenca theksoi gjithashtu rëndësinë që merr sot forcimi i kapaciteteve ushtarake të NATO-s; përshëndeti dhe solidarizohet me hapat e fundit politike dhe ushtarake që Aleanca ka marrë si pasojë e provokimeve të vazhdueshme që po bëhen, sidomos ndaj vendeve balltike.

Ajo theksoi njëkohësisht se është shumë e rëndësishme që të intensifikohet lufta ndaj dezinformimeve dhe fushatave dashakeqe kundër NATO-s, fenomen ky që ka marrë përmasa shqetësuese kohët e fundit. U dha ideja që të shikohet

mundësia për krijimin e një qendre në vendin tonë e cila të merret pikërisht me parandalimin e këtij fenomeni.

Konferenca tërhoqi vëmendjen edhe në përmirësimin e punës së medias në trajtimin e çështjeve të NATO-s. Kjo për faktin se media në vendin tonë gjithnjë ka qenë miqësore me NATO-dhe i ka bërë jehonë ngjarjeve të saj më të rëndësishme, por vihet re shpesh që në emisione televizive apo në mediane e shkruar ftohen analistë që nuk janë të fushës, jo shumë të aftë për të analizuar situata të veçanta etj.

Konferenca përshëndeti ftesën që NATO i bëri Maqedonisë së Veriut për t'u pranuar në Aleanca. Ajo theksoi nevojën e vazhdimin të politikës së dyerve të hapura në rajonin tonë dhe kërkoi që Kosova të institucionalizojë marrëdhëniet e saj me NATO-n. Gjithashtu u përshëndetën hapat konkrete të ndërmara nga Asociacioni Atlantik i Kosovës për t'u antarësuar në Shoqatën e Traktatit të Veriut në Bruksel, fillimisht si vëzhgues. Këtu u theksua edhe roli i rëndësishëm që ka luajtur në këtë drejtim Këshilli Atlantik i Shqipërisë.

HISTORIA

76-vjetori i luftës së Pojskës: Tre vëllezërit, Reshit, Muharrem e

Kontributi i Familjes



Ing. Myfit GUXHOLLI*

Në Historinë e lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, janë të rralla ato Familje që iu përkushtuan maksimalisht kësaj lufte të lavdishme, siç ishte Familja Çollaku, me kontributin e vyer të tre djemve: Reshit, Muharrem e Astrit Çollaku.

I pari, Heroi i Popullit Reshit Çollaku, komandant i Çetës së Mokrës (Pogradec), që renditet si Çeta e parë partizane në Qarkun e Korçës dhe e dytë në Shqipëri, pas çetës së Pezës, që me krijimin e saj në 27 Mars 1942 dhe dy vëllezërit e tij, Muharremi dëshmor dhe Astriti, gazetar e funksionar i pushtetit vendor...

KUSH ISHTE RESHIT ÇOLLAKU

Reshit Çollaku, lindi në Pogradec me 1914 ku mbaroi dhe shkollën fillore. Më vonë vazhdoi mësimet në Tiranë dhe për katër vjet në gjimnaz. Pas kësaj kaloi në gjimnazin ushtarak në Romë. Vitet e fundit i bëri në Akademinë Ushtarake të Modenas në Itali, ku e gjeti edhe pushtimi i Atdheut nga hordhitë fashiste. Kjo ngjarje e kobshme e tronditi dhe e trishtoi së tepërmi sepse u shkel liria. Në 12 prill 1939, Komanda e Akademisë, në mënyrë pompoze organizon një mbledhje, gjoja me të gjithë shqiptarët që të bënin betimin ushtarak para dy flamurëve shqiptarë dhe flamurëve italiane me sëpatat e fashizmit. Komandanti i Akademisë mori fjalën nga Koloneli dhe përshëndeti. Kur filloi t'u flasë oficerëve shqiptarë se ata duhet të krenoheshin për ata flamuj, Reshiti ju përgjigj: "Ne do të krenohemi me flamurin tonë kur ta mbrojmë me gjokset tona dhe kur ta shohim këtu në Itali, të mbajtur nga duart e ushtarëve shqiptarë si në kohën kur Skënderbeu i erdhi në ndihmë Ferdinandit të Napolit, dhe jo të rrethuar nga bajonetat tuaja". Më pas Koloneli i ftoi të gjithë ushtarakët shqiptarë të betohen, duke thënë "Lo giuro", por ata nuk e pasuan. Gjenerali i tha Kolonelit: "A dinë italisht këta apo jo?". Në këmbim të fjalëve të betimit, Reshiti foli përsëri: "Nuk na gënjeni me propagandën tuaj" dhe me pas vijoi: "Unë jam betuar një herë për Shqipërinë dhe një betim të dytë e quaj të turpshëm dhe korruptonjës". Mbas bojkotit të mësimet për tre ditë ata u mblodhën përsëri. Koloneli i ftoi përsëri për të bërë betimin përpara flamurit kombëtar, por askush nuk del përpara për t'u betuar. Atmosfera elektrizohet, gjokset filluan të ndizen, të gjithë i kanë sytë tek Reshiti, por ky tashme nuk është në vendin e tij. Duke lënë shokët pas, i qetë, i sigurtë, plot vendosmëri, me kokën lart e sytë drejtuar në fytyrën e oficerit fashist, Reshiti filloi të flasë: "Na ndjeni zotërinj, ky flamur nuk është i yni. Për çdo shqiptar të vërtetë është krejt i huaj, prandaj ne s'kemi pse të betohemi përpara një cope bezeje të kuqe që ka aq vlerë sa edhe copat e bezeve me të cilat mbështjellim këmbët". Reshiti u përkrah edhe nga disa shokë të tjerë. Mbledhja u prish dhe Reshiti u vu në arrest. Pas disa ditësh erdhi në Shqipëri dhe mënyrë ilegale kaloi kufirin për në Jugosllavi ku u takua me shqiptarë të tjerë

- *Heroi i Popullit Reshit Çollaku dhe dy vëllezërit, Muharremi dhe Astriti ishin djemtë e Isuf Hysen Çollakut, i njohur si luftëtar i paepur për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, i cili më 1912 ngriti flamurin e pavarësisë në Pogradec, së bashku me patriotët tjerë*



të arratisur. Kur u pushtua Jugosllavia në 1941, u kthye në Shqipëri për të dhënë kontributin e tij për vendin e okupuar nga fashizmi dhe qëndroi ilegal në zonën e Mokrës. Në Shqipëri kishte filluar lëvizja e Luftës kundër fashizmit deri në çlirimin përfundimtar të Atdheut. Reshiti mbështeti menjëherë këtë lëvizje dhe u rreshtua të luftonte. Qysh në fillim ai mori pjesë në demonstratën e madhe të 29 nëntorit 1941, duke qëndruar në radhët e para të demonstruesve. Pastaj kaloi në malësinë Mokrës dhe me pushkë e besë punoi pa u lodhur për mobilizimin e popullit në luftë. Në 27 mars 1942 u formua Çeta e Mokrës dhe komandant i saj u caktuar Reshit Çollaku, nën udhëheqjen e të cilit ajo u bë tmerr për fashistët italianë.

Një vit më vonë, pikërisht më 17 Maj 1943, në fshatin Pleshisht të Mokrës së Sipërme, grumbullohen të gjitha forcat partizane të çetës së krahinës, forcat e çetave të vogla në bazë fshati si dhe njesiteve guerile, shndërrohen në një formacion me të gjerë partizan. Pra formohet Batalioni Partizan me komandant, akademistin ushtarak Reshit Çollaku, një patriot i flaktë që studio mundësitë për të organizuar në Mokrën kreshnike dhe trime njësi guerile, çeta partizane dhe në fund, Batalionin partizan. Ai e njëjtte Mokren dhe Mokrarët ashtu siç edhe ata e njihnin atë se ishte një djalë i këtyre maleve dhe e bëri Mokren një kala të pamposhtur të LANÇ-it. Reshit Çollaku u vu në krye të forcave partizane në këto krahina dhe në krye të partizanëve mori pjesë në shumë luftime. Premtim i tij gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte: "Do t'i luftoj deri në fund pushtuesit italianë në këtë Luftë Çlirimtare, do të jem me popullin, miqtë dhe shokët e mij që kanë rrëmbyer armët dhe luftojnë kundër fashistëve italianë këtu në Mokër dhe në gjithë Shqipërinë".

Reshiti kishte një kulturë dhe e njihte artin ushtarak. Ishte shumë i çiltër, i qeshur, me sy të zinj që i ndritnin në një fytyrë të mprehtë. Portreti i tij ishte portret i një komandanti partizan të matur dhe të qetë. Ai ishte vetëm trim i vendosur, fjalën që thoshte e maste, nuk fliste shumë, por fjalët i kishte rë qeshura e me zjarr.

Reshiti mbeti i vrarë në betejën së Pojskës më 16 korrik.

Reshiti e vuri në pritë batalionin që komandonte dhe në Pojskë doli shesh për shesh, vuri në pozicion mitralozin dhe hapi zjarr gjer u godit dhe ra bashkë me disa shokë.

POJSKA E 16 KORRIKUT '43

Epopeja e Pojskës mban datën 16 korrik '43. Ajo ka në qendër të saj protagonistin kryesor, Reshit Çollakun. Gjithçka erdhi natyrshëm, si pjesë e zh-

villimeve luftarake të djemve e vajzave antifashiste të Pogradecit. Si pjesë e nevojës për të zhdukur pushtuesin italian nga trojet shqiptare. Vetë beteja e njohur me emrin e zonës së Pojskës u zhvillua nga partizanët e batalionit të Mokrës që komandohej nga Reshit Çollaku, në bashkëpunim me forcat e rrethit të Elbasanit. Vendimi për të sulmuar në Pojskë u përcaktua nga shtabi operativ, para një konsulte paraprake ku u diskutua për ta dhënë goditjen aty apo në anën tjetër të Qafë Thanës. Pasi u përzgjedh goditja në zonën e Pojskës, Reshit Çollaku mblodhi batalionin dhe detajoi detyrat. Sipas planit të tij, partizanët u ndanë në katër grupe. Në krahun e djathtë (nga ana e Pogradecit) do të operonte grupi i komanduar nga Nexhat Hyseni dhe Hetem Haxhiu. Në të majtë partizanët e drejtuar nga Muharrem Çollaku dhe Xhevit Hyseni. Në qendër vetë kreu i batalionit, Reshit Çollaku, që do sulmonte me mitralozin e rëndë. Ndërkaq një grup tjetër i drejtuar nga Abaz Ago do qëndronte i tërhequr për t'i paraprirë goditjeve nga shpina. Me marrjen e urdhrat, forcat nisën lëvizjen nga vargmali në drejtim të fushës. Pavarësisht rezervave që kishte shfaqur për sulmin në fushën e Pojskës, Reshit Çollaku u vu në ball të betejës duke zgjedhur pozicionin më të rrezikshëm për vete...

I PARI RA KOMANDANTI

Vetëm pak çaste pasi forcat ishin pozicionuar në të dy krahët e rrugës automobilistike, u duk motoçikleta e parë me një civil. Pas saj, 2-3 makina me ushtarë italianë. Pa mbërritur mirë në mesin e fushës, Reshit Çollaku i gozhdoi në vend me sulmin e befasishëm me mitraloz. Thirrjeve të tij "Arrendetini", (dorëzohuni) italianët do t'i përgjigjeshin me një kundërsulm të rrufeshëm. Reagimin e tyre do ta bënte edhe më agresiv ardhja e një autoblinde me



HISTORIA

Astrit Çollaku në pozicionin luftarak

Çollaku gjatë LANÇ-it



GJIMNAZI «MUHARREM ÇOLLAKU» POGRADECI

ushtarë të tjerë. Prapa saj një autobлиндë tjetër dhe një veturë. Njëherazi me sulmin e Reshitit kishin filluar të godisnin nga të gjitha krahët edhe partizanët e tjerë. Përpjekja sa vinte e bëhej më e ashpër. Komanda italiane mbasi studioi situatën dhe raportin e forcave, i kërkoi shtabit epror për t'i çuar në ndihmë forca të tjera. Sakaq nga Korça, Pogradeci, Struga e Elbasani filluan të vinin përforcime. Po kështu nga liqeni hapte zjarr një motovedetë me topa dhe mitraloz. Nga ajri vepronte një aeroplan, i cili mitralonte pa pushim pozicionet e partizanëve. I gjithë ky rrebesh i kundërshtarëve fillimisht krijoi situatë kërcënuese për grupin e partizanëve që vepronte në qendër. I pari ra komandanti Reshit Çol-

laku. Pas tij e mori komandën Siri Kodra n/komandant i batalionit të Dumresë. Po dhe ai do të binte pas pak çastesh për ta vazhduar drejtimin Spiro Gjijnuri. Plumbi do të përshkruante ndërkaq edhe trupin e tij. Një tjetër kuadër do të merrte komandën e batalionit të gjendur në darën e rrethimit. Po edhe Ptoleme Xhuvani, ish-anëtar i komitetit të qarkorit të Elbasanit do të binte në ballë të betejës. Dhjetë martirë do t'i kushtonte beteja batalionit partizan në Pojskë deri në momentin e tërheqjes së rrezikshme. Një humbje shumë e madhe që do të ishte katastrofike pa realizuar tërheqjen. Forcat italiane pësuan një humbje jo të vogël, me 25 ushtarë të vrarë dhe shumë armatim të kapur. Pojska do të ishte ndërkaq varri i gjeneralit italian dhe tre ushtarakëve të lartë, që kishin ardhur për përforcime.

NËNA E MUHARREM ÇOLLAKUT: "TRIMAT NUK QAHEN. DJEMTË IA FALA SHQIPËRISË!"

Muharrem Çollaku, kuadër dhe luftëtar trim, lindi në Pogradec në vitin 1920 në një familje të herëshme patriotike. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, më pas familja e dërgoi për të ndjekur studimet në "Normalen" e Elbasanit, për arsimtar.

Qysh në fëmijëri dallohej për një temperament të gjallë e të hedhur. Në shkollë kishte tiparet e një të riu të pjekur, studjues dhe inteligjent. Në këtë kohë zienin diskutimet për gjendjen sociale e ekonomike të rënduar të vendit, si dhe për idetë e reja revolucionare. Diskutonte me zell me shokë si Veli Dedi, Emrush Myftari etj. Me ta kishte shoqëri të ngushtë nga ana e vëllait të madh, Reshitit. Bisedat e tyre të ngushta për luftën kundër okupatorit ndikonin tek Muharremi.

Urrejta kundra fashizmit i kishte lindur vite më parë gjatë bisedave që i jati i tyre bënte me tre djemtë: Reshitin, Muharremin dhe më të voglin, Astritin.

Babai i tyre, kur shihte vrullin e djemve, nuk i ndalonte, përkundrazi i inkurajonte që të bashkoheshin me shokët në luftën për çlirimin e atdheut.

Muharremi zinte një vend të dukshëm në ato ditë të zjarra, duke u bërë iniciator për rrëmbimin e armëve në depot e armikut.

Pas mbarimit të shkollës Normale të Elbasanit, Muharremi emërohet mësues në Kosovë, por duke parë gjendjen e rënduar nën robërinë serbe bën një propagandë intensive kundër tyre. Në Gjilan të Kosovës jetonte në një shtëpi me udhëheqësin kosovar të LANÇ-it, Fadil Hoxha. Veprimtaria e tij ra në sy ndaj dhe u detyrua të largohej nga Kosova për të mos u burgosur.

Letërkëmbimet më të vëllain, Reshitin dhe takimet me shokët antifashistë e brumosën më shumë dhe e

nxitën për luftë kundër okupatorit.

Muharremi doli partizan në Çetën e Mokrës që komandohej nga i vëllai Reshiti, që me krijimin e saj. Si i ri i shkolluar i ngjiste fjala si me të rinjtë dhe me të moshuarit, ndërkohë u bë një nga luftëtarët më aktivë të çetës.

Në luftën e Pojskës, ai me një grup shokësh u caktua në krahun e majtë për të mbrojtur shokët e qendrës, ku ishte dhe komandant Reshiti. E përjetoi rëndë vrasjen e të vëllait që u përjetësua me lavdi si Hero i Popullit.

...Më 20 tetor gjermanët rrethojnë Pogradecin e çliruar nga partizanët. Muharremi me shokët e Shtabit të Korçës ishin bazuar në shtëpinë e xhaxhait të tij. Kur filloi lufta, Muharremi me të jatin dhe Nexhip Vinçanin dolën nga shtëpia për të organizuar tërheqjen. Mirëpo gjermanët kishin zënë disa pozicione kyçe, si kodra mbi shtëpinë e tyre Gjermanët hapin zjarr dhe plagoset i jati dhe vetë Muharremi, lehtë.

Gjithsesi edhe në këto kushte u munduar të tërhiqen për tek kalaja e Pogradecit që kishte lartësi dominuese për gjithë qytetin, por ajo ishte e zënë nga forcat gjermane dhe në luftim e sipër, për të shpëtuar shokët shkëmbyen zjarr me gjermanët. Fatkeqsisht ai vritet 5 metra larg majës dominuese. Gjatë varrimit të tij nëna trimreshë Qerime Ymer Çollaku u shpreh: "Trimat nuk qahen. Reshitin dhe Muharremin ja kam falur atdheut. Të rrojë Shqipëria!"

Në majën e kalasë u ngrit lapidari që përjetëson jetën e partizanit trim Muharrem Çollaku.

Në Pogradec, Heroi i Popullit është përjetësuar me emërtimin: Bulevardi "Reshit Çollaku", ndërsa e para shkollë e mesme, gjimnaz, mban emrin "Muharrem Çollaku".

ASTRIT ÇOLLAKU, GAZETAR DHE FUNKSIONAR I PUSHTETIT VENDOR

Astrit Çollaku ka lindur në Pogradec më 1927. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje. Mbaroi shkëlqyeshëm edhe të mësme. Ndonëse i ri edhe ai, si dy vëllezërit, Reshiti e Muharremi, doli partizan dhe luftoi heroikisht kundra pushtuesit.

Pas çlirimit punoi si gazetar i "Zërit të Popullit".

Më pas vjen nga Tirana në Pogradec si nënkryetar i Komitetit Ekzekutiv.

Heroi i Popullit Reshit Çollaku dhe dy vëllezërit, Muharremi dhe Astriti ishin djemtë e Isuf Hysen Çollakut, i njohur si luftëtar i paepur për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, i cili më 1912 ngriti flamurin e pavarësisë në Pogradec, së bashku me patriotët tjerë.

**Nënkryetar i OBVL-së*



Reshit Çollaku

(Baladë poradecare)

Nga LASGUSH PORADECI

Hajde-haj, Reshit Çollaku,
Në atë gjoks të zjente gjaku,
Djalë i mbarë i Mokrës-plakë
Ndezur zjarr e ndezur flakë.
Dole me njësitn' e parë,
Me ata djem poradecarë,
Bëre siç të tha Partia,
Siç tha vetë Shqipëria.
Mokr' e Gorë brigje-brigje,
Digje, bre, Çollaku, digje,
Dil në Pojskë që prej malit,
Që nga Shpell' e Rodokalit.
Kollovaz për tatëpjetë
Zbrit lëshoh në sulm rrufetë,
Zbrit me burrat partizanë,
Ndize Pojskën anembanë.
Ndale armikun mes xhadesë,
Futu brenda në fortesë,
Shkatërro beton e hekur,
Ngrit flamurin e pavdekur.
Përmi top, përmi mortaja
Ngule sa më lart në majë,
Vraj sa mund, e shtriu vetë,
Komandant shqiptar me fletë!
Kur u vra Reshit Çollaku
Kur nga gjoksi i plasi gjaku,
Ç'pati thënë e kuvenduar?
Ç' foli trimi i trimëruar?
"Hëni shok', mos më qani,
Mos më qani e zi mos mbani,
Se nuk vdes, por rron i gjallë
Kush jep shpirt me yll në ballë".

1974

REFLEKSIONE

Kosova shënoi Ditën e Lirisë, 20-vjetorin e hyrjes ushtarake të NATO-s

NGA PLANET GJENOCIDE SERBE DERI TE ÇLIRIMI I KOSOVËS



Nga Bashkim Hisari

Në qershor të vitit 1999, forcat serbe në Kosovë vazhdonin me krime më makabre. Vuajtjet vazhdonin. Në shenjë hakmarrjeje për shkak të bombardimeve të NATO-së, ndaj shqiptarëve ushtrohej dhuna, sidomos ndaj civilëve. Me vepërime ç'njerëzore vriteshin shqiptarët e pafajshëm. Vazhdonin përndjekjet politike, dëbimet, torturat, burgosjet...Nuk kishte ngelur objekt privat dhe shoqëror pa u plaçkitur, demoluar dhe shkatërruar, duke përfshirë edhe shkollat dhe monumentet historike e fetare.

Përdorimi i pakontrolluar i forcës, zbatimi i dhunës dhe kërcënimit, kishin krijuar atmosferë frike të paparë gjithëandej Kosovës. Popullësinë civile shqiptare, forcat serbe e përdornin si mburoje kundër sulmeve të NATO-së. Për shkak të rrezikut, popullësia, shpëtimin vazhdonte të kërkonte duke ikur. Njerëzit donin të jetonin edhe në pyllin e vetmisë, larg shtëpisë, fshatit dhe qytetit të tyre, sa më largë nga kriminelët me uniforma serbe. Iknin në male e kodra, mbijetonin nën tende prej najloni ose pëlhure, pa ushqim të mjaftueshëm dhe në kushte të mjerueshme higijenike. Shumica iknin dhe shpëtimin e gjenin në Shqipëri, por edhe në Maqedoni, në Mal të Zi dhe vende tjera.

MAKINERIA PUSHTUESE SERBE NUK KURSENTE ASKEND DHE ASGJË NË KOSOVË

Meqë isha i punësuar në organizatën ndërkombëtare për monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Kosovë, në rrugën Prizren-Morinë, vështroja kolonat e gjata të atyre që largoheshin nga Kosova. Isha dëshimtar okular i vuajtjeve dhe dhembjeve të njerëzëve mbi traktorë, kamiona, karroca dhe të atyre që ecnin në këmbë. Burra, gra e fëmijë ishin të lodhur, të frikësuar e traumizuar. Me plagë shpirtërore tregonin histori të tmerrshme. Një vajzë e re e prekur thellë në ndjenjat duke qarë kërkonte nënën e saj. Një burrë plak nga fshati Krushë e Vogël tregonte se si forcat paramilitare serbe, në një objekt për qëndrimin e bagëtive në periferi të fshatit, i kishin mbyllur burrat, vurë zjarrin dhe i kishin bërë shkrumb e hi mbi 100 bashkëfshatarë të tij. Një djal i ri pohonte se rrugës drejt kufirit shqiptar ka parë kufoma të hedhura nëpër fusha, gropa dhe kanale. Në një karrocë plotë me gra e fëmijë, një grua me dy djemë e një vajzë përkrah, përshkruante, plaçkitjet dhe vrasjet në Rahovec, të tjerët përsëritnin se policët dhe paramilitarët serbë, kishin keqëtrajtuar barbarisht shumë civilë të pambrojtur dhe të pafajshëm duke thënë me urrejtje: "dëshët NATO-n,

• *Intervenimi i NATO-s, në Kosovë, para 20 viteve ka qenë i domosdoshëm. Ndërhyrja pati domethënje të veçantë, përveç çlirimit mundësoi krijimin e shtetit të Kosovës dhe pengoi destabilizimin e gjendjes në Ballkan*



urdhëroni, tani le të shërojnë ata plagët e juaja". Megjithatë, shumica ishin optimist se NATO-ja dhe UÇK-a do sjellin lirinë dhe deklaronin se do të kërthen në shtëpitë e tyre. Edhe pse Aleanca i dërgoi letër të hapur udhëheqësish jugosllave që të ndërmarr aksione konkrete për vendosjen e paqes dhe paralajmronte se do të organizojnë një forcë të madhe për ruajtjen e paqes, forcat serbe vazhduan sulmet kundër shqiptarëve. Makinaria pushtuese serbe nuk kursente askend dhe asgjë në Kosovë. Zullumin e shtuan edhe në veri të Shqipërisë. Në rajonin veri-lindor të Shqipërisë gjendja ishte shumë e rëndë. Në Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve, predhat e artilerisë serbe ranë në qytetin e Krumës ku afër spitalit civil u plagos djaloshi 20-vjeçar. Goditën edhe fshatrat Pogaj, Cahan, Bardhoc dhe Vlahen. Zjarri i artilerisë serbe goditi edhe pikën e kufirit në Morinë. Në zonën e Kukësit, si pasojë e bombardimeve, kishin dëmtuar repetitorin e televizionit të Kukësit, sinjali i të cilit transmetohej edhe në drejtim të Kosovës.

MARRËVESHJA E KUMANOVËS REZULTAT I KAPITULLIMIT TË SERBISË

Derisa avionët e NATO-s vazhdonin misionin e tyre duke goditur caqet serbe, propaganda serbe lansonte dezinformata se shqiptarët po shpërngulen për shkak të bombardimeve të NATO-s kurse mediat ndërkombëtare, regjimin e Slobodan Milosheviçit e krahasonin me atë nacistë.

Më 6 qershor 1999, të shtënat e armëve të rënda, topave, minahedhësve, mortajave dhe rafalet e mitrolezeve, nga zona e kufirit me Shqipërinë dhe nga ana e malit Pashtrik, dëgjoheshin më pak se zakonisht. Lufta e UÇK-s gjithnjë e më shumë ndërkombëtarizonte çështjen e Kosovës dhe shënonte fitore. Ishin këto sinjale se sulmet e dhe bombardimet e NATO-s, do të ndërpriten dhe Serbia do kapitulloi. Në Kumanovë, më 9 qershor, u nënshkrua një marrëveshje teknike ushtarake midis NATO-s dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, e cila i dha fund bombardimeve të atij shteti. Marrëveshja e Kumanovës ishte rezultat i kapitullimit të Serbisë në përballje nga bombardimet e NATO-s dhe UÇK-s. Më 9 qershor 1999, Slobodan Milosheviçi dhe gjeneralët e tij gjakatarë pranuan kapitullimin pa kushte. Marrëveshja tekniko-ushtarake u nënshkrua në Kumanovë nga Gjenerali i forcave të NATO-s, Majk Xheksion dhe

nga gjeneralët serb Svetozar Marjanović e Obrad Stefanović. Marrëveshja parashi-konte tërheqjen e plotë të të gjitha forcave ushtarake e policore të Serbisë-Jugosllavisë nga Kosova. Nga Kosova duhet të largoheshin të gjitha forcat e RFJ-së, që përfshinin forcat ushtarake, grupet e armatosura civile, grupet asociative paramilitare, forcat ajrore, gardat kombëtare, policinë kufitare, rezervat ushtarake, policinë ushtarake, shërbimet e inteligjencës, Ministrinë federale dhe serbe të punëve të brendshme, policisë lokale, speciale, ato kundër trazirave dhe antiterorist dhe çfarëdo grupi apo individ tjetër, që përcaktohet nga komandanti i forcave ndërkombëtare të sigurisë (KFOR).

SERBËT IKNIN NGA KOSOVA SEPSE KISHIN KRYER KRIME TË RËNDA GJENOCIDI

Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në mbledhjen e tij të 4011-të, miratoi rezolutën 1254. OKB para kësaj kishte miratuar disa rezoluta por gjendjen në Kosovë por, ato nuk u respektuan dhe nuk tejkalonin Marrëveshjen e Rambujes. Ndërkaq, respektimin e Rezolutës 1254 e garantonte Marrëveshja e Kumanovës dhe vendosja e forcave të NATO-s. Me këtë resolute, rol të rëndësishëm iu dha OKB-së e cila vendosi administratën ndërkombëtare në Kosovë. Në kuadër të KFOR-it, më 12 qershor 1999, në Kosovë filloi vendosja e rreth 50.000 ushtarëve nga 36 vende, prej të cilëve 30.000 ishin nga vendet e NATO-s. Në çdo qytet ku hynin forcat e NATO-s, shqiptarët gëzoheshin. Përkundër faktit se forcat serbe kapituluan dhe u larguan nga Kosova, Beogradi zyrtar deklaronte fitoren. Rreth një milion shqiptarë të cilët u dëbuan nga forcat e Milosheviçit, filluan të kthehen në shtëpitë e tyre, ndërsa serbët bashkë me ushtarët e policët, iknin në Serbi. Iknin sepse kishin bërë shumë dëme dhe kryer krime të rënda mizore të gjenocidit. Kishin vrarë dhe masakruar më shumë se 13.500 shqiptarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftime, prej tyre 1.393 fëmijë, 1.379 gra. Mbi 1.600 persona ende janë të pagjetur. Vetëm brenda një dite, më 26 mars 1999, në disa fshatra të zones së Prizrenit, forcat serbe vranë dhe ekzekutuan 652 civilë shqiptarë (Landovicë, 17, Krushë e Vogël 115, Krushë e Madhe 264, Celinë 81, Fortesë 65, Pastasellë 110). Në Serbi janë zbuluar varrezat masive me 941 kufoma të shqiptarëve të vrarë në Kosovë. Në Qendrën për trajnimin e Një-

sive speciale të Ministrisë për Punë të Brendshme kundër Terorizmit në Batajnicë afër Beogradit, në varrezë massive u gjetën 744 kufoma. Trupat e kosovarëve tjerë të vrarë u gjetën në varreza massive në Petrovo Selo, në liqenin Peruçac, në Rudnicë dhe në një kamion-frigorifer në lumin Danub. Rreth 20.000 gra e burra vlersohet se ishin viktime të dhunës seksuale. Me forcë kishin dëbuar afro një milionë kosovarë dhe plaçkitur pronat e tyre dhe pronën publike. Kishin shkatërruar e dëmtuar objektet civile, monumentet historike, arsimore dhe fetare...Ardhja e paqeruajtësve shënoi një kthesë vendimtare për fatet e popullit të Kosovës. Ishte kjo një fitore e madhe për luftën e drejtë të popullit shqiptarë, një ditë me rëndësi që përcaktoi zhvillimin e mëtejshëm për historinë e Kosovës edhe një nga ditët më domethënëse dhe më kuptimplotë për lirinë dhe për pavarësinë e saj. Ishin momente të bukura dhe të veçanta kur shqiptarët përjetuan gëzime që nuk mund të përsëriten.

20 VJETË PAS ÇLIRIMIT, NË KOSOVË ÇDO GJË ËSHTË NDRYSHJE

Tani Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Ka institucionet e veta, trupat paqeruajtëse të KFOR-it janë në numër më të vogël dhe numërojnë afro 6 mijë ushtarë, të cilët janë të dislokuar në pjesë të ndryshme të Kosovës me mision paqeruajtës. Ka policinë kurse Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK-në), është transformuar në ushtri të vendit. Mirëpo, qytetarët shprehin pakënaqësi pse shteti i tyre nuk është në gjendje të organizohet dhe të udhëhiqet ashtu si duhet. Aktualisht, Kosova po kalon nëpër një periudhë të vështirë. Mungesa e plotë e funksionimit të sistemit të drejtësisë, krimi i organizuar, zbatimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe dukurit tjera negative, janë brengosëse dhe sfida që nuk po tejkalohet. Kosova ende nuk ka aritur të sigurojë gjyqësi, polici dhe prokurori të pavarur nga politika dhe nga klanet e ndryshme të interesit. Andaj, te qytetarët, mbi-zotron ndenja e përbashkët e epidemisë së pakënaqësisë ndaj qeveritarëve që po e udhëheqin shtetin të cilët, me tendenca autoritare, po e shfrytëzojnë periudhën e tranzicionit dhe dobësitë e demokracisë së brishtë që ka mundësuar të marrin kontrollin e pushtetit ekzekutiv që atyre po u sjell fitime dhe pasuri të paligjshme. Me të drejtë kërkojnë Kosova të jetë shtet në interes të qytetarit ku zbatohen ligjet për të dalur sa më shpejt nga anarkia dhe nga pozita e një shteti të dështuar në të cilin, parat e taksa paguesëve harxhohen pa dhënë llogari askujt, plaçkitet pronat private dhe publike, manipulohet me tenderë, ku ndërtohen me mija pallate pa leje, punësohen pa kriter familjarë e pushtetarëve dhe militantët partiak dhe ku arsimi dhe shëndetësia nuk kanë kurëfarë vlere. Për të bërë ndryshime dhe për të arritur sukses duhet me efikasitet të neutralizohen dhe të eliminohen të gjithë ata që mirren me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Duhet të bëhet pastrimi i plotë i organeve shtetërore. Për të arritur këto caqe, Kosova ka nevojë për njerëzë ndryshe, më bashkëkohorë, demokrat të vërtet që kanë vizion për të ndërtuar shtetin më mirë, që do të angazhohen seriozisht që shteti i tyre të arrijë hapin e humbur dhe ta kthejë shpresën e anëtarësimit të Kosovës në BE dhe në Aleancën Veri-Atlantike.

HISTORIA E LANÇ

Lufta për heqjen e flamurit shqiptar nga Vukmanoviç Tempo dhe maqedonasit, protesta e tij drejtuar Tiranës

PARTIZANËT DIBRANË ME 8 SHTATOR 1943 VENDOSËN FLAMURIN SHQIPTAR NË DIBËR TË MADHE

Nga Sakip Cami

Kapiten Ahmet Cami, komandant i Çetës së Gollobordës u caktua komandant i forcave partizane dhe i rendit e i qetësisë në këtë qytet. Ahmeti vendosi tek bashkia e qytetit flamurin shqiptar kuq e zi.

Dëshmori Ahmet Cami, komandant i Çetës së Gollobordës

Ahmet Cami deklaroi: “Po u hoq flamuri shqiptar, gjithë qyteti është i rrethuar dhe nuk do të ndahemi mirë sepse ky është qytet shqiptar”. Dhe në fakt nuk u hoq flamuri shqiptar deri pas largimit të forcave partizane nga Dibra e Madhe .

Ditët e fundit portali Kujto.al dhe dosja.al si dhe disa gazeta të përditëshme botuan disa lajme të pavërteta dhe denigruese për partizanët dibranë, të Batalionit të Dibrës. Ata kanë shfrytëzuar një material arkivor të cilin e kanë shfrytëzuar qëllimisht të pjesshëm dhe të copëtuar. Të bën përshtypje që këto portale dashakeqëse merren me plaçkitjet e depove italiane nga shqiptarët e uritur e të xhveshur të vitit 1943 dhe jo me luftën që u bë për vendosjen e flamurit shqiptar në këtë qytet të copëtuar nga vendimet e padrejta të vitit 1913. Këtë fakt e kalojnë fare përciptasi, kur për këtë flamur dhe për këtë gjest heroik është derdhur shumë gjak shqiptari.

Edit Durham shkruan:

“Dibra ka vuajtur rëndë si pasojë e luftës, sepse kufiri është vendosur ndërmjet dibranëve dhe qytetit të Dibrës që është tregu i tyre. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi të madhe në të dy anët e kufirit, madje edhe ndonjë luftim. Në asnjë rrethanë nuk duhet bërë që një kufi ta ndajë tokën e një fisi në mes në rast se ata që e caktojnë këtë kufi, dëshirojnë të vendosin paqe”. (Edit Durham “Brenga e Ballkanit, 1913_.

Luftimet midis shqiptarëve (dibranëve) dhe serbëve kanë vazhduar për 9 vjet me rradhë, (1913 – 1921) për të mos ua lënë Dibrën e Madhe serbve sepse ishte ndarëpopulli dhe shpirti i tij përgjysmë. Konkretisht fshatrat e Gollobordës lindore, Viçishtit, Tërbaçit, Sepetovës, Gjoricës, Shupenzës dhe Maqellarës të gjitha rezistencat dhe luftat kundër pushtuesve të huaj i kanë bërë bashkë sepse përbëjnë një etni kombëtare, kulturore, gjuhësore, psiqike dhe luftarake. Nuk ka familje të këtyre fshatrave që nuk kishin dhe nuk kanë lidhje të gjakut, dajallarë e kushurinjtë, me të cilët nuk mund të ndaheshin vetëm për faktin që është vënë një kufi ndarës. Dibra e madhe dhe fshatrat saj si dhe fshatrat fqinj që përmenda më lart kanë qenë bashkë edhe në prill të vitit 1941 ku

kjo rezistencë pati edhe dëshmorët e saj. (T.Cani, „Etnokultura dibrane ndër shekuj“, mbajtur në Dibër të Madhe në vitin 1993)

Gjatë luftës së II Botërore dhe gjatë luftës antifashiste Nacional Çlirimtare çështja për bashkimin e trojeve shqiptare doli në rend të ditës, u shtua dëshira dhe përpjekjet për ta realizuar këtë bashkim.

Në këtë periudhë ka egzistuar parulla e fashizmit dhe nazizmit për Shqipërinë etnike, ka egzistuar rezistenca e maqedonasve e serbve për të mos i lëshuar tokat e marra padrejtësisht nga viti 1913, ka egzistuar qëndrimi i përbashkët i aleatëve anglo-ruso-amerikanë, që kufijtë të shikohen pas mbarimit të luftës dhe ka egzistuar dhe janë bërë përpjekje reale nga partizanët shqiptarë për ta marrë Dibrën me luftë dhe për ta bërë fakt të kryer bashkimin.

Për Dibrën e Madhe partizanët dibranë kanë zhvilluar dy luftëra të mëdha kundër gjermanëve në tetor dhe nënëntor 1943 ku janë vrarë dëshmorët Jashar Kola, Hamdi Lleshi dhe shumë të tjerë. Ndërsa në shtator 1944 është bërë lufta e tretë ku janë vrarë edhe shumë partizanë të Br. XVIII të Dibrës. Dibranët e Dibrës dhe të Dibrës së Madhe i kanë mbështetur bijtë e saj dhe u janë mirënjohës në jetë të jetëve dëshmorëve dhe partizanëve që derdhen gjakun kundër pushtuesve.

Tani na dalin disa antishqiptarë dhe propogandojnë pas 76 viteve se partizanët dibranë kanë vjedhur e plaçkitur.

Abdi Golja nuk përfaqëson LANÇ. Ai është prefekt i emëruar nga qeveria kuizlinge fashiste e kohës. Materiali është kaq shumë kontradiktor sa që pohon vetë që edhe firma është e fallsifikuar. Përkundrazi Prefekti Abdi Golja me shkresën Nr 382 datë 13/12/1943 ka kërkuar arrestimin e anëtarëve të Këshillit Nacional Çlirimtar të Dibrës.

Porositë dhe urdhërat e Misionit ushtarak anglez dhe të kapitenit Hands që ka qenë në ato kohë në Dibër dhe në Dibër të Madhe kanë qenë: “Peshkopinë mund ta sulmoni e ta çlironi, por jo Dibrën e Madhe. Dibrën e Madhe do ta çlirojnë të tjerë...”

KAPITULLIMI I ITALISË FASHISTE, HYRJA NË DIBËR TË MADHE, VENDOSJA E FLAMURIT SHQIPTAR

Shtator 1943. Italia fashiste ka kapitulluar. Në qytetin e Dibrës së Madhe forcat italiane kërkojnë të largohen. Qytetin e ka marrë në dorëzim Aqif Lleshi, xhaxhai i Haxhi Lleshit, komandant i çetës territoriale antifashiste. Forcat partizane të Batalionit të

Dibrës kërkojnë të marrin në dorëzim qytetin.

Kërkohej takim me gjeneralin italian, i cili i prit, i takoi dhe kërkoi takim me Haxhi Lleshin. Haxhi Lleshi ndodhej në Labinot në konferencë. Shkojnë përfaqësuesit e tjerë të LANÇ, Zoi Themeli, Sotir Vullkani, përkthyesi etj. Në takim vijnë edhe pjestarët e emisionit ushtarak anglez. Ndërkohë Aqif Lleshi kishte marrë drejtimin e qytetit dhe kishte filluar çarmatosjen e çdo qytetari që shikohej me armë. Lejohej të merrej nga depot italiane vetëm materiale ushqimore dhe veshmbathje si plaçkë lufte, jo armatim dhe municion. Ndërkohë kishte filluar një rrëmujë në qytet.

Komanda e Batalionit të Dibrës takon Aqif Lleshin dhe i thotë se komandën e vendit do ta marrë shtabi partizan. Aqifi ra dakord dhe brenda dy orëve ai njoftoi parinë e Dibrës dhe qytetin e Dibrës ua lëshoi patrullave partizane. Për robërit italianë të mbetur në qytet u bë kujdes që të shpërndaheshin nëpër shtëpia dhe të trajtoheshin mirë. Populli i Dibrës i trajtoi ata më së miri deri në mbarimin e Luftës së II Botërore, kur u kthyen në atdheun e tyre.

Kapiten Ahmet Cami, komandant i Çetës së Gollobordës u caktua nga shtabi i batalionit komandant i forcave partizane dhe i rendit e i qetësisë në këtë qytet. Atij ju besua drejtimi jo vetëm i çetës së Gollobordës, por edhe i një pjese të forcave të çetës së Grykës së Madhe dhe të një pjese të Batalionit të Martaneshit. Ahmeti rivendosi rendin e cënau nga elementë turbullues e përfitues vendas dhe të ardhur në qytet për përfitime dhe fillimisht vendosi tek bashkia e qytetit flamurin shqiptar. Hapi burgun dhe liroi të burgosurit që mbaheshin nga fashistët.

Udhëheqësi politik i Maqedonisë Svetozar Vukmanoviç Tempo dhe ndihmësi i tij Kërste Cervenkovski kishin urdhëruar që të hiqej flamuri shqiptar dhe të vihej flamuri jugosllav sepse këtë të drejtë ua njehej Vendimi i Fuqive të Mëdha në vitin 1913. Por Ahmet Cami thotë: “Po u hoq flamuri shqiptar, gjithë qyteti është i rrethuar dhe nuk do të ndahemi mirë sepse ky është qytet shqiptar”. Dhe në fakt nuk u hoq flamuri shqiptar deri pas largimit të forcave partizane nga Dibra e Madhe.

Janë të njohura protestat që bëri Vukmanoviç Tempo tek Shtabi i Përgjithshëm i UANÇ dhe tek Enver Hoxha si dhe letrat e 13 dhe 23 shtatorit 1943, ku kërkohej me arrogancë largimi i menjëhershëm i reparteve partizane shqiptare nga qyteti i Dibrës së Madhe. Kjo shkaktoi më vonë prishjen e bashkëpunimit të UANÇ me ushtrinë antifashiste maqedonase dhe atë jugosllave në tërësi.



Ahmet Cami
1900 - 1943

donase dhe atë jugosllave në tërësi.

DIVIZIONI ITALIAN „FIRENCE“ QË NDODHEJ NË DIBËR DORZOHET DHE BASHKOHET ME FORCAT NACIONAL ÇLIRIMTARE

Shtabi i Përgjithshëm i UANÇ i bëri një thirrje të posaçme trupave italiane që ndodheshin në Shqipëri për të bashkëpunuar me ta në luftë kundër okupatorit të ri gjerman.

Komandana e Divizionit „Firence“ është e para dhe e vetmja njësi e madhe ushtarake italiane, e komanduar nga komandanti Gjenerali Arnaldo Azzi dhe Zv.komandanti gjeneral Piccini që realizoi marrëveshjen me përfaqësuesit e forcave partizane dhe me Haxhi Lleshin për të kaluar në anën e UANÇ dhe bashkë me partizanët e Dibrës dhe të Matit mori pjesë në disa luftime kundër gjermanëve.

Shtabi i batalionit partizan të Dibrës me efektiv të vetin i shoqëroi vetë trupat italiane në Dibër, Mat dhe Krujë, që ato të mos goditeshin qoftë edhe gabimisht nga trupat partizane dhe ato vullnetare. Në shkallë vendi kaluan rreth 15 mijë forca italiane me forcat e UANÇ, të cilat u inkuadruan në Batalionin dhe më vonë në Brigadën e në Divizionin „Antonio Gramsci“. Në Dibër dhe në Dibër të Madhe dhanë jetën 20 partizanë italianë, të cilët janë shpallur dëshmorë nga Qeveria shqiptare.

Për situatën e krijuar në qytetin e Dibrës së Madhe Ministri i Brendshëm në një shkresë të datës 14 shtator 1943 shkruan:

Mbretëria Shqiptare

Ministria e Punve të Brendshme

Zyra Politike

Nr. 635/255

Shkurtim: Çeta të armatosura në Dibër

Tiranë, 14.9.1943

Kemi informata se ditën e enjte me datën 9 të këtij muaji ushtria italiane, Divizioni „Firence“ që ndodhej në Dibër të Madhe, mbasi ka djegur depot e municionit është larguar në drejtim të Bulqizës e rajonit të Burrelit, tuj lëshue qytetin e Dibrës, çetave komuniste të kryesuese prej Haxhi Lleshit.“

LIBRI



SHPENDI TOPOLLAJ

Tepër i vëmendshëm në temat që zgjedh dhe shumë skrupuloz në trajtimin eruditiv të tyre, Ylli Polovina, me të gjithë librat e tij të shumtë, ku mjeshtërisht di të alternojë letërsinë me historinë, është bërë një autor mjaft i respektuar dhe i kërkuar nga lexuesit e çdo kategorie. Kjo bije në sy se dhe te libri i botuar tash së fundi, kushtuar familjes mjaft të njohur kolonjare të Butkallinjve, e cila s'është tjetër veçse një ilustrim mjaft i goditur i gjithçkaje ngjau në Shqipërinë e gjithë shekullit që lamë pas. Dy kapele kuptimplota të vendosura në kopertinë; njëra e oficerit me simbol yllin e kuq dhe tjetra qeleshe e bardhë me shqiponjën e zezë të nacionalistëve, armike për vdekje mes tyre, të paralajmërojnë për gjithësa do ndeshesh gjatë leximit të këtij libri me ngjashmëri romani. Komunistë e ballistë, partizanë e bashkëpunëtorë të armikut, bejlerë e fshatarë të varfër, shtypës e të shtypur, patriotë e tradhtarë, pasanikë e shërbëtorë, trima e frikacakë, etj. janë epitetet inatçore dhe aq dëmprurëse që nuk na janë ndarë prej dekadash të tëra dhe nga përçarja e të cilave ende sot e kësaj dite nuk po e marrim veten.

Është punuar djallëzisht për hir të pushtetit, për ta mbajtur ndezur këtë luftë të turpshme mes shqiptarëve, pa e vrarë mendjen aspak se pikërisht ky zjarr përvëlues ferri, na ka dëmtuar shumë e shumë më tepër se vetë pushtimi i armiqve ndër shekuj. Kemi një jetë të tërë që altoparantët trullasës të propagandas hileqare na e kanë topitur mendjen deri në ekstrem, dhe vazhdojmë

ta shohim njëri - tjetrin me egërsi, si kundërshtarë të papajtuësishëm. Pikërisht kjo psikologji primitive që na mundon e pengon në çdo hap që bëjmë dhe na shndërron në qesharakë në sytë e botës të qytetëruar, natyrisht që ka qenë dhe vështirësia më e madhe që autorin Polovina e ka stepur para se t'i futet punës për shkruarjen e këtij libri. Lukiani, "Volteri i lashtësisë klasike", duke dhënë këshillat e tij të mençura sesi duhet shkruar historia, ka thënë se "Detyra e historianit nuk është si ajo e oratorit; ajo që është e nevojshme të thuhet, duhet thënë ashtu siç është në të vërtetë. Sepse ajo që u bë, u bë e mori fund; lipset vetëm të renditet materiali dhe të parashtruhet në rregull" Dhe vazhdon: "Kësisoj historiani duhet të vrasë mendjen jo se çfarë të thotë, por se si ta thotë." Dhe Ylli Polovina ka pasur guximin të tejkalojë mbi legjendat e thurura padrejtësisht nga politikanët komunistë apo ata historianë që të detyruar, kanë shtrembëruar realitetin, pra edhe mbi shumë opinione të gabuara, dhe t'i qëndrojnë besnik vetëm atyre që në rrethana të caktuara kanë ngjarë. Dhe dashje pa dashje, në ato ngjarje që përshkruan, ka korrigjuar shmangiet nga e vërteta historike. Në këtë mënyrë, ai ka ndjekur rrugën sokratike për të kryer detyrën më të lartë, atë të kërimit të së vërtetës.

Kështu është natyra njerëzore, e koklavitur dhe e ndikuar nga rrethanat. Prandaj, nobelisti H. Hesse thosh se "Kurrë njeriu nuk është përsosshmërisht i shenjtë apo errësisht mëkatar." Të tillë janë dhe personazhet që ka nxjerrë familja Butka, që aq bukur i portretizon

Rreth librit "Historia e Shqipërisë kalon edhe nga Butka" të Ylli Polovinës

KUR LETËRSIA I VJEN NË NDIHMË HISTORISË

Ylli Polovina dhe ku vendin më të rëndësishëm e zë jeta e Fetahut dhe patjetër ajo e djalit të xhaxhait të tij Safetit, thuajse vëllait të tij, pasi Fetahut, babanë, ja vranë në 1911-ën, kështu që atë dhe Qemalin i rriti Saliu. Kuptohet që ndodhitë kanë të domosdoshme vendosjen në kohë dhe hapësirë. Ylli vetë nuk është kolonjar, por unë si i tillë jam befasuar dhe mrekulluar nga pikturimet e tij për vendet, zakonet, atdhetarinë, trimërinë, dëshirën për dije dhe kulturë, bujarinë, mikpritjen, besnikërinë e deri gatimet e banorëve të atyre fshatrave. Kam ndier aromën e papërsëritshme të atij vendi, mirësinë e banorëve të saj, shijen e veçantë të gatimeve të atyre grave të papërtuara e nikoqire, melodinë e atyre këngëve. Ai hyn në botën e tyre të brendshme, hulumton atje, përligj e justifikon sjelljet e tyre. Na tregon se në familjen e Butkajve apo në atë trevë, asgjë nuk vjen nga hiçi. Patriotizmi dhe virtytet e tjera, si gjithçka tjetër, janë të trashëguara. Njerëzit janë sa paqësorë aq dhe luftëtarë të paepur, kur vendin e kërcënojnë të huajt. Nuk e kanë për gjë të rrokin armët dhe duke lënë ngrohtësinë e zjarrit të vatrës dhe fëmijët e gratë pa përkrahje, të marrin malet me dëborë, ku i ftohti të than e uria të grin.

Dhe s'dihet në kthehesh i gjallë. Dhe në këto situata të rënda, ruajnë qetësinë dhe shpesh krijojnë vjersha. Kush e ka lexuar librin me poezi të Sali Butkës apo ato që na jep në këtë libër Polovina si krijime nga partizani Muharrem Butka, bindet lehtë për natyrën e kolonjarit. Janë të njohura trimëritë e Sali Butkës apo djalit të tij dëshmor Ganiut etj. por nga familja e tyre, personalitete si Safeti, Fetahu etj. gjithnjë për të njëjtin qëllim, përdorën autoritetin dhe ndikimin e tyre për shtimin e radhëve të luftëtarëve për lirinë e vendit, në çetat që ata komandonin. Dhe në u rreshtuan në krahë të ndryshëm, kjo ndodhi se të tilla ishin rrethanat historike; njëri përkrahte idetë komuniste dhe shpresonte në to, tjetri nuk e shihte dot me sy, nënshtrimin ndaj të huajve e sidomos atyre serbë që ende nuk qenë shlyer nga kujtesa popullore krimet e përbindshme që kishin bërë ndaj popullit tonë. Por si mund të ishte armik, fjala vjen intelektual i shquar Safet Butka, i rritur në një familje që e kishte të pikturuar sa një faqe muri, flamurin kombëtar nga i mirënjohuri Sotir Zografi? Si mund të

pajtohej ai, i biri i të madhit Sali Butka, i internuari nga italianët në Ventotene, me armiq të Shqipërisë? Kush nuk e ka lexuar, le ta lexojë librin e mikut tim të mirë, e historianit serioz, prof. Uranit për kontributin e paçmuar që babai i tij Safeti, ka dhënë për ndiçimin e mendjeve të shqiptarëve nëpërmjet rritjes së cilësisë të shkollave të asaj kohe. Dhe e tëra kjo, jo me llafë, por me dokumente zyrtare. Ndaj ndien neveri kur sheh pas kaq vitesh sesi shkruante për vetëvrasjen e tij Qarkori i Korçës: "Safet Butka, sabotator i Lëvizjes Nacional - Çlirimtare dhe ndihmës i fashizmit për ta përçarë dhe për ta hedhur në vëllavrasje popullin shqiptar". Personalisht, jam bir i partizanit të orëve të para të Çetës së Kolonjës dhe batalionit "Hakmarrja" dhe e di mirë se im atë në luftën e Blushit u plagos në kokë nga ballistët. Por mos vallë duhet të mbetem i verbër në gënjeshtat e komunizmit që ende vazhdon të mbjellë ndarje mes shqiptarëve të pafajshëm. Enver Hoxha me shokë damkosi, burgosi e pushkatoi ata që i kishte në krah gjatë gjithë asaj kohe dhe si faqeji që ish, nuk e vriste aspak ndërgjegja për njerëz që gëzonin autoritet në popull pa menduar ideologjikisht e politikisht si ai e ca më shumë që mund t'i rrezikonin karrigen e pushtetit. Polovina mjaft qartë dhe me vepër e vepër protagonistësh, na e ka dhënë luftën për pushtet dhe si futej ajo deri brenda gjirit të familjes. Nuk ka qenë në traditën e shqiptarit, por komunizmi e realizoi poshtërsisht të armiqtonte edhe vëllanë me vëllanë. T'i armiqtonte deri atje sa t'i vinin pushkën njëri - tjetrit.

Turp! Kur u shpreha pak më lart se ky libër është ndërtuar si një roman, kisha parasysh se ai depërton deri në disa hollësi të çuditshme, vendesh, ngjarjesh e karakteresh. Pa folur pastaj për një vijimësi e harmoni ndodhish në kohë. Nuk është e lehtë të flasësh me data e orë apo me dëshmitarë e dialogje mes tyre, me aq saktësi. Ashtu sikurse autori nuk ka fshehur asgjë nga të mirat apo mangësitë e personazheve. Vetëm kështu ai bëhet më i besueshëm për lexuesin. Askënd nuk e gjykon për vepërimet e tij; ai vetëm jep faktin. Atë punë le ta bëjnë vetë lexuesit. Dhe lexuesi i ka ment në kokë, nuk ka pse gënjehet më. E sheh se Safeti është një nga patriotët më të mëdhenj e sedërqar, i cili nuk e duron peshën e imponuar të vëllavrasjes, Fetahu vuan padrejtësisht burgjeve dhe interni-

meve, sikurse sheh mizoritë e xhelatëve të sigurimit që janë çnjerëzore, hakmarrja ndaj familjeve të të dënuarve është përtej çdo përfytyrimi, terrori dhe përgjimi i çdo të dyshuari nuk ndalen, varfërimi i popullit vjen duke u trashur, izolimi i pashembullt, dëshira për ta lënë vendin nuk rresht, historia shtrembërohet sipas rastit, e sidomos dëshirave të vetë udhëheqësit paranojak.

Ai shpif pa pikën e gajles për kë t'i mbushet mendja. Si shkruan në një botim, nuk shkruan në tjetrin. Ylli Polovina, rigoroz në kërkesat ndaj vetes, ka shfrytëzuar edhe mjaft dokumente që flasin vetë rreth këtyre ngjarjeve dhe personazheve. Edhe qëndrimi i grave të kësaj familje të madhe, vajzave apo nuseve është si i amazonave. Ato paraqiten burrensha dhe dinë t'i përballojnë me dinjitet dhe ndershmëri fatet, vuajtjet, sakrificat e privacionet e burrave të tyre, për të mos thënë se ishin si ato që ndeshi lundërtari spanjoll Orelana në brigjet e lumit Maranon dhe i kishin të gjitha cilësitë për të shërbyer si modele të statujës së Polikletit.

Ndodh që edhe në mal të shkonin pas bashkëshortëve, siç është rasti i të shoqes së Muharremit, partizanit trim dhe i vlerësuar edhe nga lugati Enver Hoxha. Kur ata nuk janë në shtëpi, dinë t'u dali për zot fëmijëve dhe të presin e përcjellin me të gjitha nderimet miqtë, partizanë a ballistë qofshin ata. Kur burrat janë në burg, i ndjekin me trasta në duar dhe asnjëherë nuk ankohen ndaj tyre kur i fusin në ndonjë kasolle për kafshët.

E tillë është e gjithë familja e Sali Butkës. Ndaj dhe të tillë mbeten edhe atje në arrati a mërgim ku janë vendosur, siç na jepet në libër rasti i arkitektit Qemal Butka, i cili që nga Amerika nuk e harroi kurrë vendlindjen e tij dhe për të cilën pasi e vizitoi thosh: "Ishte e lodhur dhe e drobitur Shqipëria, kur e pashë. M'u duk kockë e lëkurë. Por unë kam shpresë se ajo do të bëhet".

Dhe patjetër do të bëhet, se njerëz si Butkallinjë ka ende ky vend dhe shkrimtarë të përgjegjshëm, të ndershëm e kurajozë si Ylli Polovina që aq bukur e korrigjojnë historinë, do kemi përherë mes nesh. Ashtu sikurse kishte Franca dikur, nga ata që shpresonin se do bëhej më mirë, sipas dëshirës së V. Hygoit: "Ah sikur vargu im, varg i gjallë e plot furi / Të mund të shtypte dhe të bënte shkumb e hi / Çdo sofist dhe tiran shpirtzi!"

PROMOVIMI

Autori, "Qytetar Nderi" i Dibrës, ka botuar 51 libra në harkun kohor të tri dekadave

Enciklopedia e plotë për Dibrën, punim me vlera shkencore nga Fatos Daci



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

KRAHINË ME HISTORI SHEKULLORE

Përpjekja për të hartuar një Enciklopedi për Dibrën nga Fatos Daci, anëtarë i përhershëm i Akademisë Amerikano-Shqiptare të Shencave dhe Arteve në Nju Jork, SHBA, ka filluar që në vitet '70 të shek. XX. Shkrim pas shkrimi në organet e kohës të shtypit lokal dhe kombëtar, ka arritur që gërmë pas gërme të hedhë në letër historinë e Dibrës, të kësaj krahine me histori shekullore dhe lavdiplotë në faqen e Shqipërisë.

Për të organizuar këtë enciklopedi me baza sa më shkencore dhe në funksion të qëllimit të shtruar që herët në moshën e rinisë autori Fatos Daci, si dhe me fillimin e shekullit të ri, mendimin e konsolidoi dhe filloi punën për hartimin e kriterëve, të ndërtimit të zërave në tërësi e për çdo fushë, sipas madhësisë së zërit (në zë shumë i madh, i madh, i mesëm dhe i vogël), në bazë krahine, fshati, ngjarje dhe individë.

Në themel të kësaj pune shembullore autori, ka ditur të marrë të dhëna arkivore (qendrore e lokale), materiale të muzeve (në nivel qarku, rrethi dhe ato qendrore), botime të ndryshme shkencore e historike në shkallë krahine dhe kombëtare për të gjitha fushat, historik të fshatrave të hartuar në vitet 1960-1990, botim të monografive kushtuar personalitetëve të ndryshme dhe fshatrave të veçantë apo të vetë Krahinës së Dibrës, të shtypit të përditshëm dhe periodik në të gjitha kohërat.

Ndaj dhe kjo Enciklopedi përbën përpjekjen e parë për botimin e plotë në nivel rajonal por dhe kombëtar, për një kaza, sanxhak, prefekturë, qark relativisht shumë i madh (me rreth 200 fshatra) për të vijuar më pas me botime të ngjashme për fshatra dhe zona të tjera të qarkut të Dibrës, të cilat do të krijonin bazën e nevojshme për botimin e Enciklopedisë së Dibrës.

PËRCAKTIMIN SHKENCOR I KRITEREVE

Enciklopedia e Dibrës, që i është dhënë lexuesit, përmban rreth 2.000 zëra nga të gjitha fushat. Zërat me karakter gjeografik janë rreth 150, ku të bie në sy peizazhi gjeografik e natyror si dhe ai kulturor, veçoritë themelore të relievit dhe të individualitetit që e karakterizon Dibrën, shumëllojshmëria e dukurive, të luftërave,



të arsimit, të kulturës, të traditave, të ndarjeve administrative në sisteme të ndryshme shoqërore etj. Tek kapitulli kryesor Arsimi, zënë vend të dukshëm puna e madhe e bërë për çeljen e shkollave, rritjen dhe zgjerimin e tyre në periudha të ndryshme të zhvillimeve shoqërore, (sipas fshatrave dhe në shkallë Dibre e më gjërë) zënë pjesën më të madhe të saj me 800 zëra (nga të cilët 60 për shkolla, 45 për gazeta dhe 600 për ndodhi dhe ngjarje historike, por dhe për personalitete që kanë ndikuar në jetën politike, ushtarake, ekonomike dhe sociale të Dibrës.

Në përzgjedhjen e zëra të ndryshme autori ka mbajtur parasysh dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me Dibrën. Parë nga ky kënd, ai ka pranuar që të zënë vend të gjithë ata persona që kanë lindur në Dibër apo që kanë lindur në vende të tjera, por me prindër të lindur në Dibër, e që kanë kontribuar me të gjitha mënyrat për zhvillimin dhe përparimin e sektorëve të jetës në Dibër.

Autori Fatos Daci ka treguar një kujdes të veçantë në përcaktimin e kriterëve për përfshirjen e ndodhive, të ngjarjeve dhe të dukurive dibrane në këtë vëllim të madh enciklopedik, e ndarë kjo në katër periudha:


-Në periudhën nga lashtësia deri në prag të shpalljes së pavarësisë kanë zënë vend betejat e Skënderbeut dhe të tjera pas tij, përpjekjet e bëra për çeljen e shkollave shqipe, të betejave dhe luftimeve, si dhe të drejtuesëve dhe pjesëmarrësve në to, të ruajtjes së traditës dhe të kulturës popullore etj.

-Në periudhën 1912-1939 zënë vend ngjarje historike, figura pjesëmarrëse krahinore e kombëtare në fushën atdhetare, shoqërore, intelektuale, shkencore, të administratës së lartë shtetërore dhe vendore, komandantë çetash luftarake të fshatrave e më gjërë;

-Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944), janë përfshirë betejat, aksione, formacione luftarake, komanda e vendit, këshillat nacionalçlirimtare, inaugurim të njësive luftarake, komanda të vendit dhe të qarqeve, kryetarët e këshillave të parë të formacioneve të ndryshme politike të fshatrave dhe të krahinës, luftime e përpjekje me forcat e ndryshme pushtuese;

fusha e arsimit, kulturës, mjekësisë dhe të ndarjes territoriale dhe administrative, të cilat e bëjnë enciklopedinë më konkrete dhe me statistika të veçanta. Në të janë vendosur 237 fotografi që tregojnë objekte dhe ndërtesa karakteristike, grupe popullore, shkolla, qendra sociale, si dhe 100 fotografi me pamje të përgjithshme të peizazhit natyror dhe kulturor, të qendrave të banuara, të objekteve të kultit, monumente, lapidarë, veshjeve popullore, instrumenteve të ndryshme muzikore karakteristike të krahinës, grupeve polifonike etj.

Në përbërjen e Enciklopedisë, sipas fushave, si zë më vete apo dhe në zëra të tjerë të ndryshëm, gjejmë trajtesa konkrete çështje të tilla si në kapitujt Arsimi, Kultura, Mjekësia dhe Ndarja Territoriale dhe Administrative. Kjo është një risi e veçantë, e ndërtuar me kujdes dhe që e



-Periudha pas Luftës së Dytë Botërore dhe deri me sot ka përfshirë drejtues të lartë në organet e shtetit, të administratës shtetërore qendrore e vendore (në organet vendore: kryetar lokaliteti, komune, bashkie, Komiteti Ekzekutiv, rrethi në të gjitha kohërat); anëtarë të organeve të ndryshme kushtetuese në Dibër. Emra drejtuesish në fushën e artit, arsimit, kulturës, letërsisë, shkencës, mjekësisë, folklorit, vlera njohëse për fshatra dhe vetë krahinën e Dibrës, si dhe botime memorialistike ku evidencohet kryesisht jeta dhe lufta shumëshekullore në Dibër dhe me rrezatim deri në shkallë vendi.

PASQYRIM I PLOTË DHE KONKRET

Ngjarjet historike krahinore apo dhe ato në nivel fshati trajtohen në rreth 350 zëra enciklopedisë, prej të cilëve rreth 70 janë zëra shumë të mëdhenj, 90 zëra të mëdhenj dhe rreth 190 zëra të mesëm dhe të vegjël. Përcaktimi i toponimisë së vendeve në bazë fshati, vendndodhja dhe kuptimi i emërimit të disave prej tyre, përfshijnë rreth 260 zëra.

Enciklopedia e Dibrës është e ilustruar dhe me shumë foto nga luftërat, monumente, ndërtesa karakteristike në fshat dhe në qytet, pajisje shtëpiake dhe veshje për jetesë, grupe artistike dhe sportive, si dhe tabela të ndryshme me të dhëna nga



orienton lexuesin në sytha konkrete që e bëjnë më të këndshëm leximin dhe marrjen e njohurive rreth një problem konkret.

PUNIM ME VLERA SHKENCORE

Me këtë punim të gjerë dhe të shtrirë, Enciklopedia e Dibrës e autorit Fatos Daci jep një pasqyrim të plotë dhe shkencorë të ndodhive, historive, të ngjarjeve kulmore, të traditave shekullore, të një zone të njohur në historinë kombëtare, por dhe më gjerë. Punimi ka vlera shkencore, gjuha shqipe është mjaft e pastër dhe e qartë, burimet arkivore janë të sakta dhe të plota, literature për shfrytëzimin e tyre është mjaft e bollshme.

Përmbajtja e gjërë e kësaj Enciklopedie bën të mundur që kjo të ketë dhe një rreth të gjërë përdoruesish, në radhë të parë për banorët e Dibrës, si dhe kudo ndodhen brenda dhe jashtë vendit, për studentët e universiteteve, për mësuesit e nxënësit e klasave të larta dhe të shkollave të mesme. Por kjo do të jetë shumë e dobishme dhe me vlera njohëse dhe për të gjithë kryetarët e njësive vendore, të bashkive dhe të prefekturës, për specialistët e shkencave natyrore e shoqërore, për ekonomistët e sociologët, për gazetarët e punonjësit e mediave dhe specialistë të tjerë thuajse nga të gjitha fushat e dijës, si dhe për publikun e gjërë.



PROFILI

Doktore e shkencave, gjenerale dhe juriste me karrierë të shkëlqyer

Dr. Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare Gjeneral Brigade në drejtimin e FA

(Vijon nga faqja 5)

individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t'i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtuese në disa nivele të Ushtrisë Shqiptare, deri në majën e piramidës së saj, si Zëvendës shefe e SHP të FA të RSH-së.

KUSH ËSHTË MANUSHAQE SHEHU

Ka lindur në Peshkopi më 5 nëntor të vitit 1965. Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Lartë të Oficerëve në Tiranë në vitin 1984 - 1988, emërohet Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi. Gjatë viteve 1989 - 1994, përfundon Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Në vitin 1991 merr gradën Kapiten i Parë. Nga viti 1989 - 1996, kryen disa detyra të ndryshme në Logjistikë si itenden-te batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazermimin në brigadë, deri shefe



e Logjistikës e Divizionit 1100, Shkodër. Në vitin 1996 emërohet Specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë

e mban deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000 - 2002 punon në ekipin amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si përkthyes, njëkohë-

- Është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, si dhe medalje të tjera e Çertifikata si "Sportiste e dalluar", "Në ndihmë të popullsisë në donacione të ndryshme", "Aktiviste e zbatimit të rezolutës 1325".

sisht kryen studime pasuniversitare (Kursin Themelor të Oficerit në SHP-FA dhe Kursin e Funksioneve) në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2003 merr gradën Major dhe emërohet Shefe e Shërbimit të Ushqimit në FA, detyrë që e mban deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, ka qenë nismëtare e disa projekteve të rristurimit të FA dhe anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC "për ndryshimin e strukturave të FA", si dhe anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të disa rregulloreve të ndryshme për Logjistikën në FA. Drejtuese e

Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Në vitet 2004 - 2005 përfundon ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Tur, Francë dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm "Spiro Moisiu", Tiranë. Në vitin 2006 mer gradën Nënkolonel dhe emërohet Shefe e Furnizimit të FA dhe në vitin 2007, Shefe e Protokollit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Më 8 tetor 2007 emërohet Ndihmëse e Presidentit të Republikës për Çështjet Ushtarake dhe Integrimin Euroatlantik. Gjatë kësaj periudhe, përfundon studimet në Kolejin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2010 përfundon Master Shkencor të Nivelit të Dytë (MND) në fushën Sigurisë Kombëtare dhe merr gradën "Kolonel".

Më 4 shkurt 2011 emërohet Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës.

Me 1 shtator 2012 emërohet Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil - Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes.

PJESËMARRËSE NË STËRVITJE TË PËRBASHKËTA ME VENDE ANËTARE TË NATO-S

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu ka qenë pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s, aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA dhe të rajonit. Gjatë karrierës së saj, ka qenë nismëtare e një sërë projektesh të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat ka marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura.

Më 1 nëntor 2016 emërohet Komandante e Akademisë së Nënoficerëve. Më 14 nëntor 2016 gradohet "Gjeneral Brigade", e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë që merr këtë gradë.

Më 1 dhjetor 2016 emërohet në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu është e martuar dhe ka dy fëmijë, një vajzë e një djalë.

Shqipëria duke filluar nga 1 korriku i vitit 2019 dhe deri në vitin 2021 merr kryesimin e SEDM-it

SHQIPËRIA, NGA 1 KORRIK 2019 KRYESUESE E SEDM-it

Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneral brigade Dr. Manushaqe Shehu mori pjesë në takimin e Zv/Shefave të Shtabeve të Përgjithshme të Forcave të Armatosura të vendeve të Europës Juglindore në kuadër të iniciativës së SEDM-it që u zhvillua në Shkup të Maqedonisë së Veriut.

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral brigade Dr. Manushaqe Shehu, nga data 11-13 qershor 2019, mori pjesë në takim të Zv/Shefave të Shtabeve të Përgjithshme të Forcave



të Armatosura të vendeve të Europës Juglindore që u zhvillua në Shkup në kuadër të iniciativës së SEDM-it.

Qëllimi i këtij takimi ishte për të nxitur bashkëpunimin ushtarak në Evropën Juglindore me qëllim forcimin e mëtejshëm të paqes, sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon. Aktiviteti u zhvillua

nën kujdesin e zëvendës shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut, Gjeneral Major Azim Nuredin, si vendës pritës i këtij aktiviteti.

Fjalën e hapjes së takimit e mbajti Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut, Gjeneral Lejtënant Vasko Gjurchinovski, i cili ndër të tjera theksoi se, bashkëpunimi rajonal dhe ndërveprueshmëria ndërmjet vendeve pjesëmarrëse është shumë i rëndësishëm dhe duhet të mbështetet fuqishëm nga të gjithë. Më tej takimi vazhdoi me përditësimin e aktiviteteve të kryera nga SEDM-i nga takimi i fundit i Athinës. Takimi përfundoi me nënshkrimin e protokollit të 6-të shtesë të Marrëveshjes së MPFSEE. Nëpërmjet nënshkrimit të këtij protokollit shtesë vendet pjesëmarrëse rikonfirmuan edhe njëherë përkush-

timin ndaj qëllimeve dhe parimeve të parashikuara nga Karta e Kombeve të Bashkuara, në të drejtën ndërkombëtare dhe në traktatet e marrëveshjet, angazhimit e tyre për të kontribuar për paqen dhe sigurinë dhe për të nxitur marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, si dhe forcimin e bashkëpunimit të ngushtë midis shteteve të Evropës Juglindore.

Në darkën zyrtare që u dha me rastin e përfundimit të këtij takimi të rëndësishëm, përshëndeti edhe Ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, znj. Radmilla Shekerinska Jankovska, e cila pasi vlerësoi punën e bërë nga SEDM-i gjatë këtyre dy viteve theksoi se, bashkëpunimi politik-ushtarak është shumë i rëndësishëm për forcimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon e më gjërë.

Ky ishte aktiviteti i fundit i SEDM-it, që u zhvillua me kryesimin e Greqisë, e cila e drejtoi atë në vitet 2017-2019. Duke filluar nga 1 korriku i vitit 2019 dhe deri në vitin 2021 kryesimin e SEDM-it e merr vendi ynë.

Takimi i radhës u vendos që të mbahet në muajin qershor 2020 në Bukuresht.

Besnik Gjonbrataj

